

UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО
UNIVERSITY OF TETOVA



Zyrës për Studimet e Doktoraturës të Universitetit të Tetovës
Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 16.02.2026, solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së disertacionit të doktoraturës, me titull **“Ndikimi i teorive bihevioriste dhe kognitive në procesin e të mësuarit tek nxënësit e shkollimit fillor”**, të kandidatës Shpresa Kurtishi Shabani.

Në bazë të vendimit nr. 24-129/2, të datës 16.02.2026, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Lulzim Mehmedi (kryetar), Prof. Dr. Fadbi Osmani (mentor), Prof. Dr. Ardita Ceka (anëtar), Prof.dr. Makfirete Ameti (anëtar) dhe Doc.Dr. Agron Iljazi (anëtar), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik i paraqet këtë.

R A P O R T
për vlerësimin e disertacionit të doktoratës

Të dhënat biografike të kandidatës:

Mr. Shpresa Kurtishi Shabani ka lindur më 26 janar 1977 në Tetovë, ku jeton dhe ushtron veprimtarinë e saj profesionale. Arsimin fillor e ka përfunduar në fshatin Pirok, ndërsa arsimin e mesëm në Tetovë, në Shkollën e Mesme “Nikolla Shtejn”, ku ka ndjekur paralelisht dy drejtime profesionale: teknik farmacie dhe motër medicinale (drejtimi i përgjithshëm). Ky formim i

hershëm profesional ka mundësuar ndërtimin e një baze të qëndrueshme në fushën e shëndetësisë dhe kujdesit ndaj individit.

Studimet universitare i ka përfunduar në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në Fakultetin Pedagogjik “Shën Kliment Ohridski”, ku në vitin 2001 ka diplomuar në drejtimin Edukim parashkollor në gjuhën shqipe, duke fituar titullin Profesor i diplomuar i edukimit parashkollor. Në vazhdim të zhvillimit të saj profesional dhe akademik, ka ndjekur studimet pasuniversitare në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, ku në vitin 2014 ka përfunduar studimet e magjistraturës dhe ka fituar gradën shkencore Magjistër në Menaxhim dhe Udhëheqje në Arsim. Tema e punimit të saj të magjistraturës ka trajtuar zhvillimet në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë në kontekstin e pluralizmit (1991–2012), duke reflektuar interesimin e saj për politikën arsimore dhe menaxhimin institucional.

Interesat e saj kërkimore përfshijnë menaxhimin dhe udhëheqjen në arsim, zhvillimin e politikave arsimore, cilësinë në arsim dhe rolin e institucioneve arsimore në kontekstin shoqëror bashkëkohor. Në kuadër të angazhimit të saj akademik, ajo synon të thellojë më tej kërkimin shkencor në fushën e arsimit dhe menaxhimit arsimor përmes studimeve të doktoraturës dhe kontributit në literaturën shkencore.

Ajo vazhdon të jetë e angazhuar në zhvillimin profesional dhe akademik, duke synuar avancimin e praktikave arsimore dhe menaxheriale, si dhe kontribuimin në zhvillimin e komunitetit dhe institucioneve arsimore. Në vitin akademik 2018/19 regjistron studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin Pedagogjik, me temë **“Ndikimi i teorive bihevisoriste dhe kognitive në procesin e të mësuarit tek nxënësit e shkollimit fillor”** të miratuar me datë 28.09.2023, me numër 24-670/3, nga Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Pedagogjik, nën udhëheqjen e Prof. dr. Fadbi Osmani, mentor i kandidatit.

Deri më tani, Mr. Shpresa Kurtishi Shabani në cilësi të autores ka botuar dy punimet shkencore.

Punimi i parë, u botua në revistën Centrum nr. 13, “Zhvillimet në arsim në Maqedoninë e Veriut në kushte të pluralizmit” UDC: 343.61:343.98

Punimi i dytë, u botua po në të njëjtën revistë nr. 14, “Ndikimi i teorisë kognitive dhe bihevisoriste në arsimin fillor”. USC: 616.89:343.91-056.34 (497.115)“2008/20018”.

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidatja gjatë studimeve të doktoratës:

Gjatë kësaj periudhe të studimeve të doktoratës kandidatja Shpresa Kurtishi Shabani ka kryer me sukses provimet në kuadër të studimeve të doktoraturës. Që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë e deri më sot kandidatja ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të temës. Ajo me sukses ka realizuar tre konferencat doktorate, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit.

Analizë e punimit: “Ndikimi i teorive bihevisoriste dhe kognitive në procesin e të mësuarit tek nxënësit e shkollimit fillor”

Disertacioni i doktoraturës me titull “Ndikimi i teorive bihevisoriste dhe kognitive në procesin e të mësuarit tek nxënësit e shkollimit fillor” paraqet një studim të mirëstrukturuar dhe të argumentuar shkencërisht, i cili trajton një nga çështjet themelore të pedagogjisë bashkëkohore-raportin ndërmjet teorive të të nxënës dhe praktikës konkrete mësimore në arsimin fillor.

Kandidatja ka ndërtuar një kornizë teorike solide, duke u mbështetur në literaturë bashkëkohore dhe klasike të pedagogjisë dhe psikologjisë së të nxënës. Në mënyrë të veçantë, janë trajtuar dhe analizuar teoritë bihevisoriste dhe kognitive, duke përfshirë kontributet e autorëve të njohur si Jean Piaget, B.F. Skinner dhe David Ausubel, të cilët përbëjnë bazën konceptuale të studimit. Përmes një analize kritike dhe krahasuese, kandidatja arrin të evidentojë dallimet, ndërthurjet dhe rëndësinë e këtyre qasjeve në organizimin e procesit mësimor.

Struktura e disertacionit është logjike dhe e ndërtuar në mënyrë progresive, duke filluar nga trajtimi i sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, analizimi i faktorëve që ndikojnë në të nxënës, deri te shtjellimi i teorive didaktike dhe teorive të të nxënës. Në këtë kontekst, punimi reflekton një qasje integruese, ku teoria lidhet ngushtë me praktikën dhe realitetin arsimor.

Një element i rëndësishëm i këtij punimi është analiza e rolit të mësimsdhënësit dhe nxënësit në procesin mësimor, si dhe theksimi i nevojës për kalim nga modeli tradicional i mësimsdhënies

drejt një modeli më bashkëkohor, të orientuar drejt nxënësit dhe zhvillimit të kompetencave. Kandidatja argumenton se procesi i të nxënit duhet të jetë aktiv, ndërveprues dhe i bazuar në përvojë, duke reflektuar zhvillimet më të fundit në didaktikë.

Punimi karakterizohet nga një nivel i lartë i koherencës shkencore, përdorim korrekt i terminologjisë pedagogjike dhe një stil i qartë akademik, çka e bën atë të qëndrueshëm dhe të mbrojtshëm nga pikëpamja shkencore.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Në realizimin e këtij disertacioni kandidatja ka aplikuar një qasje të kombinuar metodologjike (mixed-methods), duke integruar metoda sasiore dhe cilësore, gjë që i jep studimit një dimension të plotë dhe të balancuar kërkimor.

Pjesa sasiore e hulumtimit është realizuar përmes përdorimit të instrumenteve të standardizuara, konkretisht pyetësorit Teacher Beliefs Survey (TBS), i cili është përdorur për të matur qëndrimet dhe besimet e mësimitdhënësve lidhur me zbatimin e teorive të të nxënit. Në studim janë përfshirë gjithsej 129 mësimitdhënës dhe 167 nxënës, të përzgjedhur nga shkolla urbane dhe rurale, duke siguruar kështu një përfaqësim të diversifikuar të mostrës.

Të dhënat e mbledhura janë analizuar përmes programeve statistikore (SPSS), duke përdorur metoda të ndryshme analitike si:

- statistika përshkruese,
- teste t për mostra të pavarura,
- analiza e variancës (ANOVA),
- analiza regressive,
- si dhe teste jo-parametrike (p.sh. Kruskal–Wallis).

Besueshmëria e instrumenteve është verifikuar përmes koeficientit Cronbach Alpha ($\alpha = 0.78$), që tregon një nivel të mirë të konsistencës së brendshme dhe rrit kredibilitetin e rezultateve.

Pjesa cilësore e studimit ka kontribuar në interpretimin më të thellë të të dhënave, duke mundësuar kuptimin e perceptimeve dhe përvojave të pjesëmarrësve në lidhje me zbatimin e teorive të të nxënit. Kombinimi i këtyre metodave mundëson triangulimin e të dhënave dhe rrit validitetin e përgjithshëm të studimit.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Rezultatet e këtij hulumtimi dëshmojnë se teoritë e të nxënit kanë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në organizimin dhe cilësinë e procesit mësimor në arsimin fillor.

Në mënyrë më konkrete, studimi nxjerr në pah se:

Qasjet e bazuara në teoritë kognitive kontribuojnë në zhvillimin e të menduarit kritik, të kuptuarit të thellë dhe të nxënit domethënës tek nxënësit.

Praktikat e mbështetura në teoritë bihevoriste janë efektive në strukturimin e mjedisit të të nxënit, menaxhimin e sjelljes dhe përforsimin e sjelljeve të dëshiruara.

Një kombinim i balancuar i këtyre dy qasjeve rezulton më efektiv në përmirësimin e rezultateve arsimore dhe në rritjen e përfshirjes së nxënësve në procesin mësimor.

Ekzistojnë dallime në nivelin e zbatimit të këtyre teorive në varësi të përvojës profesionale, kontekstit shkollor dhe trajnimeve të mësimdhënësve.

Zbatimi i teorive është i lidhur ngushtë me mbështetjen institucionale, zhvillimin profesional dhe strukturën e kurrikulës.

Rezultatet e studimit janë të argumentuara mirë statistikiisht dhe të interpretuara në mënyrë kritike, duke u lidhur me literaturën ekzistuese dhe duke reflektuar realitetin arsimor në vend.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatës:

Kontributi shkencor i këtij disertacioni është i shumëanshëm dhe me vlerë për fushën e pedagogjisë dhe didaktikës:

Sjell një analizë të thelluar teorike dhe empirike mbi ndikimin e teorive të të nxënit në arsimin fillor në kontekstin e RMV.

Ofron një model konceptual për integrimin e teorive biheviariste dhe kognitive në praktikën mësimore.

Siguron të dhëna empirike relevante që pasqyrojnë gjendjen reale të praktikës mësimore në shkollat fillore.

Evidenton sfidat dhe nevojat për përmirësim në sistemin arsimor, duke kontribuar në zhvillimin e politikave arsimore.

Jep rekomandime konkrete për:

mësimdhënësit (për përmirësimin e praktikës didaktike),

drejtuesit e shkollave (për menaxhimin pedagogjik),

dhe politikëbërësit (për reformimin e kurrikulës dhe trajnimeve).

Kontribuon në avancimin e literaturës shkencore në gjuhën shqipe dhe në kontekstin rajonal.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:

Duke u bazuar në rezultatet dhe kufizimet e këtij studimi, hapen disa drejtime të rëndësishme për hulumtime të ardhshme:

Realizimi i studimeve eksperimentale për të analizuar në mënyrë më të saktë efektet kauzale të teorive të të nxënësve në arritjet e nxënësve.

Zgjerimi i hulumtimit në nivele të tjera arsimore (arsim i mesëm dhe i lartë).

Studime krahasuese ndërmjet vendeve të rajonit për të identifikuar praktikën më të mirë.

Hulumtime mbi integrimin e teknologjisë digjitale në zbatimin e teorive të të nxënësve.

Studime longitudinale për të vlerësuar efektet afatgjata të qasjeve pedagogjike.

Analiza të ndikimit të programeve të zhvillimit profesional të mësimit në përmirësimin e praktikës mësimore.

Vlerësim dhe rekomandim:

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të disertacionit të doktoraturës “Ndikimi i teorive bihavioriste dhe kognitive në procesin e të mësuarit tek nxënësit e shkollimit fillor” të kandidatës Mr. Shpresa Kurtishi Shabani, ka nderin që t’i propozoj Këshillimit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Lulzim Mehmedi, 
2. Prof. Dr. Fadbi Osmani, 
3. Prof. Dr. Ardita Ceka, 
4. Prof. Dr. Makfirete Ameti, 
5. Doc. Dr. Agron Iljazi, 

Tetovë, 01 Prill 2026